




KRM "ÇABRATI" SH.A.

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Për Ekzekutimin e Mjeteve Financiare sipas vendimit të Qeverisë

E lidhur me datë: 28.12.2020 ndërmjet palëve:

1. Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i kësaj Komune z. Ardian Gjini, në tekstin vijues theksohet: Komuna.
2. Kompania Regjionale e Mbeturinae KRM "ÇABRATI", të cilën e përfaqëson z. Behar Ferizi Kryeshef Ekzekutiv i KRM "ÇABRATI" SH.A, në tekstin vijues theksohet: "ÇABRATI" SH.A

Neni 1 Baza ligjore

Në mbështetje të vendimit nr. 40/50 i datës 21.12.2020, për Ndërmarrjet Publike të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për bashkëfinancimin e projektit "Trajtimi i Deponisë Transfer në Komunën e Gjakovës" 01 nr. 413/01-14780, i datës 10.07.2020, Kontratës 01 nr. 41004-15644 e datës 22.07.2020 "Trajtimi i Deponisë Transfer në Komunën e Gjakovës" dhe Aneks kontrata 02 nr. 410/0424119 e datës 19.10.2020.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është zbatimi i vendimit nr. 40/50 i datës 21.12.2020, për mbështetjen e Ndërmarrjeve Publike të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, mjetet financiare në vlerë prej 400,00.00 euro ti barten kompanisë NTSH "KORBEN" (emri i biznesit Roza Komani B.I) – Gjakovë, me nr. unik 811129726, i përfaqësuar nga z. Ndue Komani, për kryerjen e obligimeve të pastrimit të deponisë transfer në Komunën e Gjakovës.

Neni 3

Përgjegjësitë e palëve

Obligimet e palëve:

3.1. Komuna e Gjakovës është e obliguar që të gjitha dokumentet në lidhje me punët dhe procesin e kryer për Deponinë e Stacionit Transfer, për largimin e mbeturinave, të ia dorëzon KRM “Çabrati” SH.A., për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës së dytë të këtij Memorandumi.

3.2. KRM “Çabrati” Sh.A. obligohet që të bëjë ekzekutimin e vendimit nr. 40/50 i datës 21.12.2020, për mbështetjen e Ndërmarrjeve Publike të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për ndarjen e mjeteve sipas dokumentacionit të pranuar nga Komuna e Gjakovës dhe sipas faturave për kryerjen e punëve të dorëzuara nga Operatori Ekonomik NTSH “KORBEN” (emri i biznesit Roza Komani B.I) – Gjakovë, me nr. unik 811129726, i përfaqësuar nga z. Ndue Komani.

Neni 4

Pjesa përfundimtare

KRM “Çabrati” Sh.A. të informon organet e administratës komunale për mbarëvajtjen e ekzekutimit të mjeteve financiare, dhe të përgatitë një raport për mbarëvajtjen e ekzekutimit të pagesave.

Neni 5

Ky memorandum është përpiluar në tre (3) kopje, prej të cilave nga një (1) kopje i dorëzohet palës kontraktuese.

PALËT

Kryetari i Komunës së Gjakovës



Ardian Gjini

Kryeshefi Ekzekutiv i KRM “Çabrati”



Behar Ferizi